



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 13.03.2023

Nr: 20

Ora: 10:00

VENDIM

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 29, DATË
11.03.2023 TË DEPOZITUAR NGA PARTIA DEMOKRATIKE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 13.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Demokratike e Shqipërisë

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 158, datë 09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin e kërkesës së PD", për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023" si dhe ndryshimin e vendimit duke vendosur, Regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, 123/1, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, neni 34, shkronja “b” dhe neni 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë depozituar dy kërkesa në emër të Partisë Demokratike për regjistrimin e kësaj partie si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023. Kërkesa me nr. 1329 Prot., datë 05.03.2023 është nënshkruar nga z. Sali Berisha në cilësinë e kryetarit të partisë. Kërkesa me nr. 1337 Prot., datë 06.03.2023 është nënshkruar z. Indrit Sefa me autorizim nga z. Lulzim Basha në cilësinë e kryetarit të partisë.
2. Të dy kërkesat janë paraqitur në emër të të njejtit subjekt politik dhe kanë të njejtin objekt, regjistrimin e “Partisë Demokratike” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023. Dokumentat që shoqërojnë kërkesat, nga ana tjetër, i japin subjektit politik dy identitete të ndryshme, të papajtueshme me njeri tjetrin. Për secilën kërkesë ndryshon së paku emri i kryetarit të partisë, i financierit dhe i personit/personave përgjegjës për komunikim me KQZ-në.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur shqyrtimin bashkarisht të të dy kërkesave “pasi bëhet fjalë për të njëjtën parti politike që kërkon të regjistrohet si subjekt zgjedhor”. Në kuadër të kësaj procedure administrative, Komisioneri ka bërë dy konstatime:
 - “Në kushtet kur sipas dokumentit zyrtar të lëshuar nga një institucion publik i ngarkuar me ligj për ta bërë këtë (gjykata), rezulton se kryetar i PD është z. Lulzim Basha, atëhere

vetëm ky i fundit ka të drejtën të paraqesi kërkesë për regjistrim të PD si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, dhe

- Autorizimi i “z. Lulzim Basha për z. Enkelejd Alibej, z. Gazment Bardhi dhe z. Indrit Sefa që veçmas, ose të gjithë bashkë ... të paraqesin kërkesën për regjistrimin e PD-së si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023” është pamjaftueshmërisht i qartë (pamjaftueshmërisht specifik) dhe deklarata solemne e zgjedhjeve nuk është nënshkruar nga kryetari i partisë z. Lulzim Basha, sikurse kërkohet obligatorisht nga shkronja “e” e nenit 64 të Kodit Zgjedhor.

4. Mbështetur në konstatimet e sipërcituara, Komisioneri ka marrë vendimin nr.158, datë 09.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratike” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, me të cilin ka vendosur “kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, “Partisë Demokratike””, duke i dhënë rrugë vetëm kërkesës me nr. 1337 Prot., datë 06.03.2023 të nënshkruar z. Indrit Sefa dhe duke lënë pa vendim kërkesën me nr. 1329 Prot., datë 05.03.2023 të nënshkruar nga z. Sali Berisha.
5. Kundër vendimit të Komisionerit nr.158, datë 09.03.2023 ka paraqitur ankim “Partia Demokratike e Shqipërisë” me kryetar z. Sali Berisha. Kërkesa ankimore që ka marrë numrin 29, është regjistruar në KQZ më datë 11.03.2023. Me shortin e datës 12.03.2023 u caktua relator anëtar i Ilirjan Rusmali, i cili caktoi seancën e shqyrtimit paraprak, ditën e hënë më datë 13.03.2023, ora 09:30.
6. Në seancën e shqyrtimit paraprak morën pjesë përfaqësuesit e ankuesit z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri dhe përfaqësuesit e administratës së KQZ-së me Sekretarin e Përgjithshëm z. Ylli Merkaj në krye.
7. Përfaqësuesit e ankuesit kërkuan përjashtimin e anëtarit Ledio Braho me arsyetimin se ky i fundit ndodhet në kushtet e pengesave ligjore sipas nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative për shkak se “ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë

në vendimmarrjen në shqyrtim” dhe se “ka marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri”.

8. KAS-i mori në shqyrtim kërkesën për përjashtimin e anëtarit dhe me shumicë votash vendosi rrëzimin e saj për shkak se marrëdhënia shoqërore me përfaqësuesin në KQZ të “Partisë Demokratike” me kryetar z. Lulzim Basha nuk formon njëanshmëri në favor të subjektit politik. Vetë subjekti politik në fjalë nuk demonstroi interes ndaj çështjes në shqyrtim, sepse nuk kërkoi të përfshihej si palë e interesuar. Nga ana tjetër, kërkuesit nuk demonstruan ekzistencën e asnjë interesi, as material, as moral tek pranimi apo refizimi i kërkesës ankimore.

KAS-i konstatoi:

1. Neni 130 i Kodit Zgjedhor i kërkon KAS-it që të verifikojë:

- a) kompetencën e KAS-it për shqyrtimin e ankimit;
- b) legjitimitimin e ankuesit; dhe
- c) respektimin e afateve ligjore për ankimin.

përpara se të kalojë në shqyrtimin në themel të saj.

2. Kërkesa ankimore nr. 29 është protokolluar në KQZ me nr.1603 prot., të datës 11.03.2023, brenda afatit tre ditor që përcakton pika 5 e nenit 124 të Kodit Zgjedhor.
3. Vendimi i Komisionerit nr. 158, datë 09.03.2023 është për nga natyra e tij vendim i ndërmjetëm. Ai nuk i ka dhënë zgjidhje në themel as kërkesës me nr. 1329 Prot., datë 05.03.2023, as kërkesës me nr. 1337 Prot., datë 06.03.2023. Komisioneri e ka detyrim ligjor që të shprehet me vendim për pranimin ose rrëzimin për secilën nga kërkesat. KAS-i është instancë e ankimit administrativ dhe jo instancë e shqyrtimit fillestar të kërkesave. KAS-i nuk mund të ushtrojë kompetenca, të cilat nuk i janë ngarkuar shprehimisht nga ligji. Kjo do të thotë se ai nuk mund të shprehet për themelin e kërkesave, pa u shprehur më parë Komisioneri si organ kompetent për shqyrtimin dhe zgjidhjen e tyre.

4. Vendimi i Komisionerit nr.158, datë 11.03.2023 ka urdhëruar “Partinë Demokratike” me kryetar z. Lulzim Basha që të bëjë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim, sipas porosive të Komisionerit. Tek ky urdhërim, “Partia Demokratike” me kryetar z. Sali Berisha nuk ka asnjë interes të ligjshëm. Nëse “Partia Demokratike” me kryetar z. Lulzim Basha duhet të urdhërohet që të plotësojë dokumentacionin ose jo, kjo është një çështje që prek vetëm interesat e ligjshme të kësaj të fundit. “Partia Demokratike” me kryetar z. Sali Berisha ka interes të ligjshëm në vendimarrjen e Komisionerit, nëse ai vendos të regjistrojë si subjekt në zgjedhje “Partinë Demokratike” me kryetar z. Lulzim Basha, ose nëse ai vendos të rrëzojë kërkesën e “Partisë Demokratike” me kryetar z. Sali Berisha për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor. Komisioneri nuk e ka marrë ende një vendim të tillë.
5. Për arsyet e shtjelluar më sipër, KAS-i konstaton se subjekti ankues nuk legjitimohet në ankimimin kundër vendimit të Komisionerit nr.158, datë 11.03.2023, dhe se KAS-it i mungon kompetenca për të vendosur si instancë fillestare “regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, sikurse kërkohet nga ankuesi.
6. Vendimi i Komisionerit nr.158, datë 11.03.2023 është vendim i ndërmjetëm. Kodi Zgjedhor nuk përmban dispozita të veçanta për vendimet e ndërmjetme që merren nga organet e tij në një procedurë administrative. Duke qenë se Komisioneri vepron gjatë shqyrtimit të kërkesave në cilësinë e përgjithshme të një *“organi publik në procedurë administrative”*, për të vlejné dhe janë të zbatueshme dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative që rregullojnë vendimet e ndërmjetme. Në nenin 67 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se vendimet e ndërmjetme merren *“kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve”*. Në gjykimin e Komisionerit, mosplotësimi i dokumentacionit shoqëruar të kërkesës nga ana e kërkuesit “Partia Demokratike” me kryetar z. Lulzim Basha do të sillte mosregjistrimin e kërkuesit si subjekt zgjedhor. Në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 68 të tij përcaktohet se vendimet e ndërmjetme bien nga fuqia kur mbaron afati i caktuar në to. Pika 2 e nenit 130 të KPrA e kategorizon vendimin e ndërmjetëm si veprim procedural (*veprimi procedural është çdo akt, veprim apo mosveprim i organit publik gjatë procedurës administrative, që nuk është një*

akt administrativ përfundimtar), kurse pika 3 e të njejtit nen përcakton se ndaj vendimit të ndërmjetëm (veprimi procedural) mund të bëhet ankim i veçantë “vetëm kur ankimi parashikohet shprehimisht nga ligji”. Kodi Zgjedhor nuk ka përcaktime të shprehura për të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimeve të ndërmjetme.

7. Në respekt të dispozitave të sipërcituara të Kodit të Procedurave Administrative, KAS-i konstaton se vendimi nr. 158, datë 11.03.2023 ka rënë nga fuqia në orën 10 të datës 11.03.2023 dhe se përcaktimi i pikës 3 të dispozitivit të tij është i pavlefshëm. Ndaj vendimeve të ndërmjetme të Komisionerit nuk mund të ushtrohet ankim i veçantë, për shkak se kjo e drejtë nuk është përcaktuar shprehimisht në Kodin Zgjedhor. Vendimet e ndërmjetme të tij mund të ankimohen vetëm bashkë me ankimin ndaj vendimit përfundimtar të procedurës konkrete administrative.
8. KAS-i konstaton se vendimi i Komisionerit për regjistrimin ose jo të kërkuesit si subjekt zgjedhor nuk mund të merret përtej afatit të përcaktuar nga pika 1, e nenit 65 të Kodit Zgjedhor, sepse përndryshe Komisioneri do të cënonte një të drejtë të rëndësishme të kërkuesit në cilësinë e tij si subjekt zgjedhor, të drejtën për të formuar dhe marrë pjesë në koalicione zgjedhore në shkallë vendi.
9. Rrëzimi i kërtimeve të paraqitura në këtë kërkesë ankimore, për shkaqet e cituara më lart, nuk prek të drejtën e kërkuesit për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar të Komisionerit lidhur me kërkesën me nr. 1329 Prot., datë 05.03.2023 në emër të Partisë Demokratike për regjistrimin e kësaj partie si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023. Në bazë të Kodit të Procedurave Administrative (neni 128), kërkuesi gëzon të drejtën e plotë që, nëse Komisioneri nuk del me vendim përfundimtar lidhur me kërkesën e sipërcituar (mosveprim administrativ), të depozitojë ankim në KAS ndaj Komisionerit për mosmarrje vendimi lidhur me kërkesën.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në emër të KQZ-së

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 29, datë 11.03.2023 të paraqitur nga ankuesi “Partia Demokratike” me kryetar z. Sali Berisha;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar